



**VENDIM MBI ZBATIMIN E
REKOMANDIMEVE TË PANELIT**

Data e miiratimit: 29 prill 2021

Nr. i lëndës: 2016-09

Slobodan Trifunović

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur më 29 prill 2021, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Guénaél METTRAUX, kryesues
Z. Petko PETKOV, anëtar
Znj. Anna AUTIO, anëtare

Ndihmuar nga:

Z. Ronald Hooghiemstra, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit më 11 dhjetor 2019,

Pas shqyrtimit përmes mjeteve elektronike, në përputhje me Rregulloren 13(3) të Rregullores së Punës së Panelit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Ankesa në këtë rast është regjistruar më 30 qershor 2016.
2. Me shkresën e datës 1 korrik 2016, Paneli ka informuar EULEX-in Kosovë se kjo lëndë ishte regjistruar.
3. Më 28 qershor 2017, Paneli i ka kërkuar ankuesit fillestar dhe ankuesve në lëndët e tjera të ofronin informata në lidhje me ankesat e tyre. Ankuesit fillimisht u përgjigj përmes përfaqësuesit se nuk kishin informacion të mëtejshme në lidhje me këto raste.
4. Më 20 shtator dhe 17 tetor 2017, Paneli i ka dërguar dy kërkesa shtesë përmes përfaqësuesit të lartpërmendur.
5. Më 20 tetor 2017, Paneli ka pranuar një përgjigje nga përfaqësuesi i ankuesve i ankuesve duke ofruar informata shtesë lidhur me dy raste, duke përfshirë edhe këtë këtu.

6. Më 8 dhjetor 2017, Paneli ia ka dërguar një deklaratë të fakteve dhe pyetjeve Misionit duke e ftuar shefin e Misionit në atë kohë që të parashtrojë përgjigjet e saj dhe vërejtjet me shkrim mbi ankesat jo më vonë se data 26 janar 2018.
7. Përmes letrës së datës 19 janar 2019, nga Misioni ishte kërkuar përsëri që të japë përgjigje për pyetjet deri më 16 shkurt 2019.
8. Vërejtjet e ShM-së u morën më 12 mars 2019, pas së cilës u janë komunikuar ankuesve për vërejtje shtesë.
9. Më 15 mars 2019, letra e ShM-së i ishte dorëzuar ankuesve për informim, të cilëve iu ishte dhënë afat deri më 15 prill 2019 për të bërë ndonjë parashtresë të mëtejshme në përgjigje të asaj letre.
10. Më 19 qershor 2019, Paneli e ka lëshuar vendimin e tij të pranueshmërisë në këtë rast, duke e shpallur ankesën të pranueshme në lidhje me nenet 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (këtu e tutje, "Konventa Evropiane" ose "Konventa") (<https://PShDNj.eu/alb/docs/Decisions/2019-06-19%20Admissibility%20Decision%202016-09-a%20pdf%20version.pdf>).
11. Më 19 shtator 2019, Misioni paraqiti përgjigjet e tij në pyetjet e Panelit.
12. Ankuesi nuk dha ndonjë përgjigje në pyetjet e Panelit.
13. Më 11 dhjetor 2019, Paneli dha 'Vendimin dhe Gjetjet' e tij, duke gjetur Misionin përgjegjës për shkeljen e të drejtave të ankuesit sipas nenit 2 (pjesë procedurale) dhe 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Në këtë bazë, Paneli nuk e pa të nevojshme të bënte përcaktime në lidhje me shkelje të mundshme nga Misioni i neneve 8 dhe 13 të Konventës. Mbi atë bazë, Paneli bëri rekomandimet e mëposhtme:

REKOMANDON si vijon:

- i. Duke marrë parasysh peshën e shkeljeve në shqyrtim e sipër, Paneli fton shefin e Misionit të shqyrtojë me kujdes mundësinë dhe nevojën që Misioni të pranojë shkeljen e të drejtave të ankuesit të kryer nga ana e Misionit;
- ii. Paneli fton Misionin të sigurojë që dosja e lëndëve që kanë të bëjnë me këtë lëndë dhe këtë vendim të dërgohen tek autoritetet vendore kompetente;
- iii. Paneli rekomandon që kjo lëndë t'i nënshtrohet monitorimit nga ana e Misionit;
- iv. Paneli rekomandon që, ashtu siç ndodhi në lëndën 2017-02, Misioni duhet të konsiderojë që t'i bëjë rekomandime autoriteteve rreth rrjedhës së mundshme hetimore në të ardhmen që mund të ndihmojë në zgjidhjen e këtij rasti; në këtë kontekst, Paneli rekomandon që Misioni të theksojë rëndësinë e të drejtave të viktimave për të vërtetën dhe të informohet për rrjedhën e përgjithshme të hetimit;
- v. Paneli rekomandon që Misioni të raportojë tek autoritetet kompetente në Bruksel nëse bëhet e qartë se autoritetet vendore nuk po i përmbushin detyrimet e tyre në lidhje me këtë;
- vi. Misioni duhet të ndërmarrë hapa aktivë për të kërkuar nga autoritetet se cilat hapa, nëse ka ndonjë, po merren për të hetuar këtë rast dhe për t'iu raportuar autoriteteve kompetente të Bashkimit Evropian në Bruksel, nëse bëhet e qartë se autoritetet nuk po përmbushin detyrimet e tyre në këtë drejtim;
- vii. Paneli rekomandon që ky vendim duhet t'iu ofrohet organeve përkatëse të Misionit; dhe

- viii. Paneli gjithashtu rekomandon që shefi i Misionit të sigurojë që aktivitetet e monitorimit të Misionit të zhvillohen në atë mënyrë që është përputhje me detyrimet e Misionit ndaj të drejtave të njeriut dhe të siguroj që kjo pjesë e mandatit të tij të kontribuojë në mbrojtjen dhe promovimin efektiv të atyre të drejtave.
14. Paneli i kërkoi Misionit të raportojë mbi zbatimin e këtyre rekomandimeve jo më vonë se data 16 mars 2020. Këto parashtrësia u morën më 22 dhjetor 2020.
15. Më 25 nëntor 2020, Paneli mësoi se ankuesi, z. Milorad Trifunović, kishte ndërruar jetë.
16. Më 29 janar 2021, Paneli kontaktoi familjen e ankuesit për të pyetur nëse ndonjë anëtar i familjes dëshironte të vazhonte me ankesën, dhe familja në fillim informoi Panelin jazyrtarisht se kishte interesim të tillë.
17. Bazuar në këtë tregues, më 2 shkurt 2021, Paneli i dërgoi një letër zyrtar familjes së ankuesit për t'i kërkuar që të informojnë zyrtarisht Panelin me shkrim për interesimin e tyre për të vazhduar me ankesën, jo më vonë se me datën 26 shkurt 2021.
18. Më 20 prill 2021, familja e ankuesit paraqiti një konfirmim zyrtar në Panel se z. Slobodan Trifunović, vëllai i ankuesit fillestar, do të pasonte z. Milorad Trifunovićin si ankues.

II. QËNDRIMI I ANKUESIT

19. Duke marrë parasysh marrëdhëniet e ngushta familjare midis viktimës kryesore, ankuesit fillestar dhe ankuesit të ri – d.m.th. vëllait të ankuesit dhe personit të zhdukur - Paneli është i bindur që ankuesi i ri mund të pasojë ankuesin fillestar dhe mund të konsiderohet si viktimë dytësore e shkeljeve të pretenduara dhe, si i tillë, viktimë e mundshme në përputhje me rregullën 25(1) të rregullores së punës së Panelit.

III. FAKTET

20. Faktet e paraqitura nga ankuesia fillestare mund të përmbliidhen si më poshtë.
21. Më 22 qershor 1998, Miroslav Trifunović, vëllai i ankuesit, Milorad Trifunović, ka shkuar në punë me autobus në minierën e Belaçevcit, Komuna e Fushë Kosovës. Ai dhe tetë punonjës të tjerë u kapën nga individë që mendohej se ishin pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në fshatin Graboc i Poshtëm, komuna e Fushë Kosovës. Miroslav Trifunović dhe punonjës të tjerë u urdhëruan të dilnin nga autobusi dhe u dërguan në një drejtim të panjohur. Që nga atëherë asgjë nuk është dëgjuar më nga ai.
22. Ankuesi dhe familja e tij njoftuan Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK), Misionin Ndërkombëtar Civil (ICM), "Zyrën e SHBA-së" (kuptohet si referencë ndaj përfaqësimit diplomatik të SHBA-së në Prishtinë), Qendrën Kulturore në Prishtinë dhe Ministrinë e Brendshme të Republikës së Serbisë dhe KNKK-në në Serbi, për zhdukjen e Miroslav Trifunovićit.
23. As z. Trifunović, e as eshtrat e tij nuk u gjetën kurrë dhe rrethanat e zhdukjes së tij mbetën të pavërtetuara. Askush nuk u soll para drejtësisë në lidhje me këtë çështje.
24. Paneli gjeti që Misioni kishte kontribuar në këtë situatë dhe në shkeljen që kishte rezultuar në të drejtat e ankuesit duke dështuar të hetojë këtë rast dhe duke mos mbajtur të informuar siç duhet të afërmit.

IV. SHQYRTIMET PARAPRAKE: VLERA DHE RËNDËSIA E AUTORITETIT TË PANELIT PËR TË PËRCJELLUR REKOMANDIMET E TIJ

25. Vendimi këtu është një vendim pasues i miratuar nga Paneli në përputhje me rregullën 45 e *tutje* të rregullores së tij të punës.
26. Autoriteti i Panelit për të ndjekur rekomandimet e tij është i padiskutueshëm. Është në përputhje me rregullat e tij dhe kjo mundësi procedurale është e vendosur mirë në praktikën dhe jurisprudencën e Panelit. Shih shtojcën A të këtij vendimi në të cilin renditen rastet në të cilat janë lëshuar vendimet pasuese.
27. Mundësia procedurale për Panelin për të ndjekur rekomandimet e tij është veçanërisht e rëndësishme në bazë të kufizimeve të vendosura në kompetencat dhe autoritetin e tij. Në veçanti, vendimet e Panelit vijnë në formën e rekomandimeve jo-detyruese. Shih, p.sh., *Thomas Rüsche kundër EULEX-it*, lënda nr. 2013-21, Vendimi mbi Zbatimin e Rekomandimeve të Panelit, 13 qershor 2017, paragrafi. 7. Shih gjithashtu PShDNj, Shënim i Praktikës Gjyqësore mbi Mjetet Juridike për Shkeljet e të Drejtave të Njeriut (<https://hrrp.eu/docs/Case%20law%20note%20on%20REMEDIES%20FOR%20HR%20VIOLATIONS.pdf>). Natyra jo-detyruese e rekomandimeve të Panelit do të thotë që, për të qenë efektiv, mekanizmi i përgjegjësisë, pjesë e të cilit Paneli bën pjesë, varet kryesisht nga pajtueshmëria e Misionit me rekomandimet e Panelit.
28. Për më tepër, mandati i Panelit nuk e lejon atë të bëjë rekomandime për dëmshpërblim financiar edhe nëse mund të ketë ofruar ndonjë mjet të përshtatshme juridik për shkeljen e të drejtave të njeriut nga Misioni. Shih, p.sh., *Zahiti kundër EULEX-it*, lënda nr. 2012-14, Vendimi mbi Zbatimin e Rekomandimeve të Panelit, 11 nëntor 2014, par. 16; X dhe 115 ankues të tjerë kundër EULEX-it, lëndë nr. 2011-20, Vendimi i katërt për Zbatimin e Rekomandimeve të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, 11 dhjetor 2019, Pjesa Operative; Raporti Vjetor 2016 i PShDNj-së, fq. 2 dhe 48-50; dhe, përsëri, PShDNj, Shënim i Praktikës Juridike mbi Mjetet Juridike për Shkeljet e të Drejtave të Njeriut (<https://hrrp.eu/docs/Case%20law%20note%20on%20REMEDIES%20FOR%20HR%20VIOLATIONS.pdf>). Përderisa kjo nuk e ka penguar Misionin, proprio motu, të ofrojë kompensim financiar për një viktimë të shkeljes së të drejtave në një numër të kufizuar të rasteve (shih, p.sh., *Zahiti kundër EULEX-it*, 2012-14, 11 nëntor 2014, paragrafët 7, 11- 12 dhe 24-26), paaftësia e Panelit për të rekomanduar këtë lloj mjeti juridik ose, në mënyrë më efektive akoma që të urdhëroj kompensimin financiar kur është e përshtatshme, ka kufizuar kompetencat e përgjegjësisë së Panelit mjaft ndjeshëm. Mungesa e mundësisë që Paneli të rekomandojë dëmshpërblimin financiar edhe atje ku do të ishte e përshtatshme do të thotë që Paneli mund të duhet të rekomandojë hapa dhe masa të cilat nuk ofrojnë lloje të plota të mjeteve juridike ose plotësisht adekuate ndaj shkeljes së të drejtave që ai ka vendosur. Kjo thekson edhe më tej nevojën që Misioni t'i kushtojë vëmendje të madhe atyre rekomandimeve juridike që janë bërë nga Paneli dhe, në masën më të madhe të mundshme, t'i zbatoj ato.
29. Pa një angazhim të plotë dhe efektiv për të mbështetur standardet e të drejtave të njeriut nga Misioni, rekomandimet e Panelit mund të krijojnë pak më shumë sesa *dukje* të llogaridhënies nga ana e Misionit. Prandaj është thelbësore që Misioni të demonstrojë përkushtimin e tij aktual ndaj atyre standardeve duke zbatuar në masën më të madhe të mundshme rekomandimet e Panelit. Paneli lëshon vendime pasuese në rastet kur Misioni konstatohet se ka shkelur të drejtat e njeriut të një ankuesi, siç është rasti këtu, si një mjet për të siguruar llogaridhënie aktuale dhe efektive nga

Misioni për shkelje të tilla. Duke marrë parasysh sa të kufizuara janë kompetencat e Panelit, një dështim nga shefi i Misionit për të zbatuar përmbajtjen e rekomandimeve të tij do ta bënte të gjithë mekanizmin e llogaridhënies joefektiv dhe iluziv nga pikëpamja e ankuesve.

V. PËRCJELLJA E REKOMANDIMEVE TË PANELIT

30. Si çështje paraprake, Paneli do të shënonte dhe përsëriste se shkeljet e atribuara nga Paneli për Misionin janë të një natyre jashtëzakonisht serioze. Ato kanë të bëjnë me disa nga të drejtat themelore më të rëndësishme të garantuara për një individ. Për më tepër, shkelja që i ngarkohet Misionit zgjati për një periudhë të gjatë dhe serioze. Ai tregoi një zhvlerësim të rëndë të detyrave dhe detyrimeve të tij në lidhje me viktimën. Në ato rrethana, Paneli pret që Misioni të ndërmarrë hapa efektivë për të siguruar që kjo shkelje të korrigjohet në mënyrë adekuate dhe të plotë. Megjithatë bazuar në atë që vijon, për Panelin është e qartë se Misioni nuk iu ka afruar as për së afërmi kësaj pritjeje.
31. Secili prej rekomandimeve të Panelit dhe përgjigja e Misionit ndaj tij do të konsiderohen me radhë.
32. Rekomandimi i parë i Panelit ishte për efektin vijues:

‘Duke marrë parasysh peshën e shkeljeve në shqyrtim, Paneli fton shefin e Misionit të shqyrtojë me kujdes mundësinë dhe nevojën që Misioni të pranojë shkeljen e të drejtave të ankuesit të kryera nga Misioni;’
33. Në vend të një pranimi të përgjegjësisë së Misionit për këto shkelje, shefi i Misionit shprehu

‘keqardhje të thellë që Misioni nuk ishte në gjendje të hetojë zhdukjen e Miroslav Trifunovic-it’ drejtë një përfundimi pozitiv.

Siç është treguar nga Paneli në rastet e mëparshme, shprehja e keqardhjes nuk është e njëjtë me pranimin e përgjegjësisë kur bëhet fjalë për korrigjimin e shkeljeve të të drejtave. Paneli shpreh keqardhje që edhe një herë Misioni përmes shefit të tij do të refuzojë të pranojë përgjegjësinë e tij për shkeljen e të drejtave të ankuesit.
34. Prandaj, Paneli konstaton se Misioni nuk e ka zbatuar rekomandimin e parë të Panelit.
35. Rekomandimi i dytë i Panelit ishte:

‘Paneli fton Misionin të sigurojë që dosja e lëndës që i përket kësaj lënde dhe këtij vendimi këtu të dërgohen tek autoritetet kompetente vendore;’
36. Shefi i Misionit tregoi se të gjitha dosjet dhe dosjet e lëndës në posedim të Misionit tani u janë dorëzuar autoriteteve vendore, duke specifikuar që dosja e lëndës në të cilën përmendet z. Miroslav Trifunović iu dorëzua Zyrës së Prokurorit Special të Republikës së Kosovës (PSRK) më 15 nëntor 2018.
37. Prandaj, Paneli është i kënaqur që rekomandimi i tij i dytë u zbatua plotësisht.
38. Rekomandimi i tretë i Panelit ishte:

‘Paneli rekomandon që kjo lëndë t’i nënshtrohet monitorimit nga ana e Misionit;’

39. Në përgjigje të këtij rekomandimi, shefi i Misionit ofroi një interpretim të gjatë të asaj çfarë ai kupton se është qëllimi dhe natyra e mandatit aktual të Misionit. Në veçanti, shefi i Misionit sugjeroi që mandati aktual i 'monitorimit' i Misionit nuk përfshinte ndonjë kompetencë për të këshilluar ose bërë rekomandime në lidhje me rastet. Shefi i Misionit gjithashtu sugjeroi që 'EULEX-i mund të mbështesë autoritetet kompetente duke dhënë rekomandime që adresojnë çështje strukturore dhe mund të kryejë detyra shtesë sipas kërkesës'. Ai shtoi se nëse autoritetet fillojnë një hetim mbi rastin e z. Trifunović, Misioni do ta monitorojë atë, meqenëse lënda 'bie në një nga fushat e tij me përparësi tematike'.
40. Paneli nuk është i bindur që shpjegimi i mësipërm ofron një pasqyrë të plotë dhe të saktë të përgjegjësive të Misionit. Së pari, pasi u gjet në shkelje të të drejtave themelore të ankuesit, tani mund të pritet që Misioni t'i korrigjojë ato shkelje. Kjo kërkon hapa efektive të ndërmarrë nga Misioni dhe ndryshimi në mandatin e Misionit nuk e ndryshon natyrën e detyrimit të Misionit për të siguruar një mjet efektiv juridik.
41. Së dyti, Misioni është ende i detyruar për të vepruar në përputhje me standardet themelore të të drejtave të njeriut. Kjo kërkon që mandati i tij aktual të interpretohet në bazë të këtyre obligimeve. Pikëpamjet e paraqitura më lart nga Misioni nuk duket se faktorizon në këto dy konsiderata.
42. Gjithashtu është e dukshme që nëse Misioni qëndron i paangazhuar me shpresën që autoritetet vendore të marrin ato që më parë ishin përgjegjësitë e Misionit, gjasat që kjo të mos ndodhë kurrë është reale. Kjo është e dukshme nga fakti tashmë që shumë dhe ndoshta të gjitha rastet e zhdukjes me forcë që kanë ardhur në Panel dhe që u pa se nuk ishin hetuar në mënyrë efektive nga Misioni nuk duket se hetohen as nga autoritetet vendore. Prandaj, Misioni, i vetëdijshëm për këtë situatë, nuk mund të pretendojë me mirëbesim se pret që kjo të ndodhë nëse nuk ndërmerren hapa për t'u kujdesur që kjo të ndodh.
43. Prandaj, Paneli e kupton që roli 'monitorues' i Misionit është gjithashtu ai që përfshin monitorimin se cilat raste ose lloje të rasteve nuk i nënshtrohen hetimit nga autoritetet vendore, ku pritet dhe kërkohet ligjërisht ta bëjnë këtë. Çdo interpretim tjetër i mandatit të Misionit do të nënkuptojë se Misioni mund të shihet si bashkëpunëtor i heshtur i dështimit nga ana e autoriteteve për të përmbushur detyrimet e tyre ndaj të drejtave të njeriut. Një situatë e tillë, nëse do të ndodhte, do të ishte në kundërshtim me angazhimin e Misionit ndaj detyrimeve të të drejtave të njeriut. Do të ishte gjithashtu plotësisht në kundërshtim me parimet e sundimit të ligjit, të cilat Misioni ka mandatin të nxisë në Kosovë.
44. Për më tepër Paneli vëren disa deklaratat publike nga zyrtarë të Misionit, përfshirë shefin e Misionit, në kuptimin e përgjithshëm se Misioni mbetet thellësisht i shqetësuar në lidhje me çështjen e personave të zhdukur. Nëse vërtet është kështu dhe Paneli dëshiron të supozojë se po, Paneli është i shqetësuar se mosveprimi nga ana e Misionit në lidhje me korrigjimin e të drejtave të njeriut të Misionit në raste të tilla si ky i tanishmi dhe në lidhje me interpretimin nga ana e Misionit e mandatit të tij që siç përshkruhet më sipër i mungon vëmendja dhe shqetësimi ceket në deklaratat publike të Misionit.
45. Prandaj, Paneli gjen se Misioni nuk e ka zbatuar rekomandimin e tretë.
46. Rekomandimi i katërt i Panelit ishte:

'Paneli rekomandon që, ashtu siç bëri në lëndën nr. 2017-02, Misioni duhet të

konsiderojë që t'i bëjë rekomandime autoriteteve lidhur me mënyrat e mundshme hetimore të ardhshme që mund të ndihmojnë në zgjidhjen e këtij rasti; në atë kontekst, Paneli rekomandon që Misioni t'iu theksojë autoriteteve rëndësinë e të drejtave të viktimave për të vërtetën, faktin që shkelja është duke vazhduar dhe që të informohet rreth rrjedhës së përgjithshme të këtij hetimi;'

47. Ajo që është thënë më lart në paragrafët 38-43 vlen këtu. Paneli nuk është i kënaqur me shpjegimin e dhënë nga shefi i Misionit që të përmbahet nga ndërmarrja e ndonjë hapi aktiv për të siguruar që çështja aktuale duhet të hetohet.

48. Prandaj, Paneli gjen se Misioni nuk e ka zbatuar rekomandimin e katërt të Panelit.

49. Rekomandimi i pestë i Panelit ishte:

'Paneli rekomandon që Misioni duhet të raportojë tek autoritetet kompetente në Bruksel nëse bëhet e qartë se autoritetet vendore nuk janë duke i përmbushur detyrimet e tyre në atë drejtim;'

50. Edhe një herë, ajo që është thënë më lart në paragrafët 29-33 vlen këtu. Nëse autoritetet vendore nuk i përmbushin detyrimet e tyre ndaj të drejtave të njeriut, Misioni nuk duhet të pretendoj se nuk është në dijeni të saj, ose që nuk ka aftësi të luajë ndonjë rol në adresimin e situatës. Paneli ka marrë shumë vendime të cilat duhet t'i kishin shkaktuar shqetësim Misionit në lidhje me atë që duket të jetë dështim istematik nga autoritetet vendore për të hetuar rastet që përfshijnë pretendimet për zhdukje me forcë të lidhura me konfliktin.

51. Në bazë të kësaj, nuk do të ishte në përputhje me obligimet e Misionit ndaj të drejtave të njeriut që të mos vepronet në bazë të kësaj njohurie. Për sa kohë që ai mendon se Misioni nuk ka mandatin e nevojshëm për të vepruar në lidhje me këtë lëndë, shefi i Misionit duhet ta ngrejë rastin tek autoritetet kompetente të BE-së me qëllim që të sigurojë që një autoritet i tillë të ofrohet siç duhet ose që autoritetet e BE-së të ndërmarrin hapa të drejtpërdrejtë për të adresuar dhe ngritur këtë tek autoritetet vendore të Kosovës;

52. Prandaj, Paneli gjen se Misioni nuk e ka zbatuar rekomandimin e pestë të Panelit.

53. Rekomandimi i gjashtë i Panelit ishte:

'Misioni duhet të ndërmarrë hapa aktivë për t'i pyetur autoritetet se cilat hapa janë ndërmarrë, nëse ka pasur, për të hetuar këtë rast dhe për t'iu raportuar autoriteteve kompetente të Bashkimit Evropian në Bruksel nëse bëhet e qartë se autoritetet nuk janë duke përmbushur detyrimet e tyre në këtë drejtim;'

54. Siç u diskutua më lart, në vend që të ndërmarrë hapat e rekomanduar, Misioni u përpoq të shpjegojë paaftësinë e tij për të vepruar bazuar në interpretimin e ngushtë të mandatit dhe detyrimeve të tij. Për arsytet e përshkruara më lart, Paneli nuk është i kënaqur me atë shpjegim dhe fton shefin e Misionit edhe një herë të shqyrtojë këtë çështje.

55. Prandaj, Paneli gjen se Misioni nuk e ka zbatuar rekomandimin e gjashtë të Panelit.

56. Rekomandimi i shtatë i Panelit ishte:

'Paneli rekomandon që vendimi aktual t'u sigurohet organeve përkatëse të Misionit;'

57. Në përgjigje, shefi i Misionit tregoi se ai u shpërnda menjëherë në të gjitha njësitë përkatëse të Misionit dhe tha se 'autoritetet përkatëse të Bashkimit Evropian në Bruksel gjithashtu informohen rregullisht për të gjitha vendimet e Panelit dhe ata gjithashtu po marrin raportin vjetor të tij. Poashtu Misioni tregoj që vendimi i Panelit u transmetua gjithashtu tek autoritetet kompetente dhe më saktësisht tek Policia e Kosovës dhe PSRK-ja. Me kërkesën e tyre, EULEX-i gjithashtu i dha PSRK-së numrin përkatës të lëndës policore me qëllim që t'u mundësojë autoriteteve të tilla të gjejnë rastin dhe dokumentacionin përkatës'.

58. Paneli është i kënaqur që Misioni ka zbatuar rekomandimin e tij të shtatë në tërësi.

59. Rekomandimi i tetë i Panelit ishte:

'Paneli gjithashtu rekomandon që shefi i Misionit të sigurojë që aktivitetet monitoruese të Misionit duhet të kryhen në atë mënyrë që është në përputhje me detyrimet e Misionit ndaj të drejtave të njeriut dhe që siguron që kjo pjesë e mandatit të tij të kontribuojë në mbrojtjen dhe promovimin efektiv të ato të drejtave.'

60. Misioni nuk e adresoi këtë rekomandim. Për arsye të përshkruara më lart, Paneli është i shqetësuar se interpretimi aktual nga Misioni për mandatin e tij mund të mos jetë në përputhje me detyrimet e Misionit ndaj të drejtave të njeriut. Në vend të kësaj, duket se dështimi i tij për të shprehur shqetësimin e tij për dështimin e autoriteteve vendore për të hetuar kategori të caktuara të rasteve - duke përfshirë edhe këtë të tanishmen - mund të krijojë përshtypjen e gabuar se ato autoritete po veprojnë në përputhje me detyrimet e tyre. Në masën që mandati i monitorimit të Misionit ka për qëllim t'u japë autoriteteve të BE dhe shteteve një pasqyrë të saktë të situatës në Kosovë për sa i përket përpjekjeve për sundimin e ligjit, ajo fotografi do të ishte plotësisht e paplotë dhe e shtrembëruar nga interpretimi i ngushtë nga ana e Misionit i përgjegjësive të veta.

61. Prandaj, Paneli gjen se Misioni nuk e ka zbatuar rekomandimin e tetë të Panelit.

62. Paneli vëren se Misioni ka argumentuar që mandati i tij i ndryshuar e ndalon atë të zbatojë plotësisht disa nga rekomandimet e Panelit. Ndërsa mandati i Misionit ka ndryshuar, Paneli thekson se Misioni është ende një dhe i njëjti. Përgjegjësia e tij i kushtohet sjelljeve të tij, të kaluarës dhe të tashmes. Dhe është përgjegjës e Misionit, siç është aktualisht, për të korrigjuar shkeljet që ai ka bërë në të kaluarën, megjithëse në një kohë kur mandati i tij ishte i ndryshëm.

PËR KËTO ARSYE, PANEL NJËZËRI

GJEN se Misioni nuk ka arritur të zbatojë në tërësi rekomandimet e Panelit, duke vërejtur se ndërsa Misioni ka zbatuar plotësisht rekomandimin e dytë dhe të shtatë të Panelit, ai nuk ka zbatuar rekomandimin e parë, të tretë, të katërt, të pestë, të gjashtë ose të tetë;

DUHET TË KËRKOJ që shefi i Misionit duhet të marrë parasysh edhe njëherë Rekomandimet e Panelit që nuk janë përmbushur plotësisht bazuar në peshën e shkeljeve të kryera nga Misioni në këtë rast, në veçanti, këto:

- Rekomandimin e parë të Panelit;
- Rekomandimin e tretë të Panelit;
- Rekomandimin e katërt të Panelit;
- Rekomandimin e pestë të Panelit;
- Rekomandimin e gjashtë të Panelit;
- Rekomandimin e tetë të Panelit;

Dhe, mbi atë bazë, **FTON SHEFIN E MISIONIT** të zbatojë masa në përgjigje të rekomandimeve të Panelit që pasqyrojnë vërtet thellësinë e angazhimit të Misionit për të zbatuar standardet e të drejtave të njeriut dhe për të korrigjuar dëmin e shkaktuar ankuesit në këtë rast;

PËRVEÇ KËSAJ, duke i pasur parasysh parashtrirat e Misionit të datës 6 dhjetor 2019 ku Misioni ka cekur se jo të gjitha rastet kanë mundur të hetohen dhe se është dashur të merreshin vendime për t'i bërë prioritizimet; **PANELI KËRKON NGA MISIONI QË T'I OFROJ INFORMATAT SI NË VIJIM:**

- i. Sa raste të zhdukjeve me forcë i ka marrë Misioni nga UNMIK-u?
- ii. Sa prej tyre janë hetuar nga Misioni gjatë mandatit të tij?
- iii. Sa prej tyre kanë rezultuar me procedim penal?
- iv. Sa raste 'të krimeve të luftës' i ka marrë Misioni nga UNMIK-u?
- v. Sa prej tyre janë hetuar nga Misioni gjatë mandatit të tij?
- vi. Sa prej tyre kanë rezultuar me procedim penal?
- vii. Cilët faktorë janë marrë parasysh me rastin e marrjes së vendimeve për caktimin e rasteve me prioritet? Kush i ka marrë ato vendime? A është dokumentuar kjo në ndonjë mënyrë? Nëse po, ju lutemi që të na siguronit dëshmi të dokumentuara.

MË TEJ REKOMANDON që ky vendim të shpërndahet në të gjitha organet përkatëse të Misionit dhe tek organet përkatëse dhe zyrtarët e Bashkimit Evropian në Bruksel;

MBETET I ANGAZHUAR në këtë çështje;

PËRFUNDIMISHT, PANELI VËREN se përgjegjësia për të siguruar një mjet efektiv juridik për shkeljet e të drejtave të kryera nga Misioni është dhe mbetet plotësisht tek vet Misioni. Në masën që Misioni, përmes shefit të Misionit nuk është në gjendje ose nuk dëshiron t'i zbatojë plotësisht rekomandimet korrigjuuese të Panelit, mbetet përgjegjësia e tij për të gjetur mjete dhe metoda alternative të korrigjimit që sigurojnë një mjet efektiv juridik për shkeljet që konstatohen se janë kryer;

FTON SHEFIN E MISIONIT të informoj Panelin për përgjigjen e tij ndaj këtij vendimi sa më shpejt që është e mundur dhe jo më vonë se me datën 30 nëntor 2021.

Për Panelin,

Guénaël METTRAUX
Kryesues

Petko PETKOV
Anëtar zëvendësues

Anna AUTIO
Anëtare

